VENDIM
Nr.606, datë 16.12.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.192, DATË 20.3.1998, "PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE, QË PRIVATIZOHEN DHE PROCEDURAT E SHITJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet, si dhe procedurat e shitjes, "kapitulli III, pika 2, paragrafi i dytë, ndryshohet si vijon:

"Për objektet e shprbimit stomatologjik dhe farmaceutik, punonjësit specialistë, që sot për sot kanë kontratë qiraje, kanë të drejtën e parablerjes pa ankand, në rastet kur këto objekte dhe trualli nën objekt nuk kanë pronarë privatë. Destinacioni i këtyre objekteve të mos ndryshojë për pesë vjet".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta